

**AKT THEMELIMI**  
**I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR**  
**“ALB MAIORA“**

Sot, me date 27.07.2024:

• **Znj. Parashevi Taga**, qytetare shqiptare lindur ne Lac, me 05.10.1993, rezidente ne Tirane, me zotesi te plote per te vepruar, mbajtese e pashaportes nr. BI6603523 mbeshtetur ne Ligjin Nr.9901 date 14.04.2008, “Per tregtaret dhe shoqerite tregtare”, ka vendosur te krijojte shoqerine tregtare me pergjegjesi te kufizuar te quajtur “ALB MAIORA” shpk me aktin e themelimit si vijon:

**FORMIMI I SHOQERISE**

**Neni 1**

Formohet shoqeria tregtare e quajtur “ALB MAIORA” sh.p.k.

**SELIA E SHOQERISE**

**Neni 2**

Selia e shoqerise tregtare “ALB MAIORA” shpk do te jete ne Tirane, Njesia Administrative nr 7, Rruga Dritan Hoxha, Ndertesa nr 11, Hyrja 3, Ap 32, Zona Kadastrale 1023.

**OBJEKTI I VEPRIMTARISE SE SHOQERISE**

**Neni 3**

Shoqeria do te kete objekt veprimtarie:

- sherbime konsulence, back office, trajnime;
- konsulence ne mardheniet tregtare kombetare dhe nderkombetare;
- sondazhe dhe analiza tregu;
- realizim dhe menaxhim faqe interneti;
- menaxhim dhe promovim ne rrjete sociale, realizim software dhe konsulence informatike;
- konsulence ne fushen e ekonomise qarkulluese dhe qendrueshmerise;
- perkthime dhe interpretime.

Shoqeria, me qellim investimin e kapitaleve te saj, mund te kete interesa dhe te marre pjese ne shoqeri te tjera qe kane objekte veprimtarie te cfaredo lloj natyre, te ngjashme, apo qe lidhen me aktivitetin e saj; ajo mund te jape gjithashtu garanci te pergjithshme, apo edhe reale per pale te treta.

Te gjitha aktivitetet e mesiperme duhet te kryhen brenda limiteve ose ne perputhje me normat qe rregullojne aktivitetin.



#### **Neni 4**

Per kryerjen e veprimtarise se saj Shoqeria mund te hape zyra te tjera, njesi perpunimi, sherbimi tregetimi dhe te bashkepunoje me persona fizike dhe juridike, vendas dhe te huaj.

### **KOHEZGJATJA E SHOQERISE**

#### **Neni 5**

Kohezgjatja e shoqerise do te jete me afat te pacaktuar.

### **KAPITALI SHOQERISE, KONTRIBUTET DHE KUOTAT**

#### **Neni 6**

Kapitali fillestar i shoqerise tregtare "**ALB MAIORA**" shpk do te jete i barabarte me Leke 100.000(njeqind mije) dhe do te perbehet nga kuota e ortakut themelues te shoqerise.

Kapitali themeltar ndahet ne 1(nje) kuote, me vlere nominale prej 100.000 (njeqind mije) leke.

**Znj. Parashevi Taga**, qytetare shqiptare lindur ne Lac, me 05.10.1993, rezidente ne Tirane, me zotesi te plote per te vepruar, mbajtese e pashaportes nr. BI6603523, ka ofruar nje kontribut ne para te barabarte me 100.000(njeqind mije) leke.

Sipas kontributit te siperpermendur shoqerise znj. Parashevi Taga, i perket 1(nje) kuote, qe i korrespondon 100% (njeqind per qind) te kapitalit te Shoqerise.

#### **Neni 7**

Kuotat e kapitalit te shoqerise dhe te drejtat qe rrjedhin prej tyre mund te transferohen sipas parashikimeve ne Statut dhe legjislacionit shqiptar ne fuqi.

### **ORGANIZIMI I SHOQERISE**

#### **Neni 8**

Organi vendimmarres i Shoqerise eshte Ortaku Themelues.

#### **Neni 9**

Ortaku Themelues ka te drejte te emeruje nje apo me shume administratore, te cilet jane perfaqesuesit ligjore te shoqerise ne menyre kolegjiale. Ata mund te nderrmarrin te gjitha veprimet e zakonshme dhe te jashtezakonshme te administrimit, por gjithmone brenda kufijve qe u jep atyre Statuti i shoqerise.

#### **Neni 10**

Konfliktet qe mund te lindin midis paleve do te gjykohen dhe zgjidhen ne zbatim te legjislacionit shqiptar.

### **Neni 11**

Shoqeria deklarohet e krijuar ne zbatim te plote te normave te statutit dhe ne perputhje me legjislacionin shqiptar ne fuqi dhe veçanerisht te Ligjit Nr.9901 date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregetare".

### **Neni 12**

Akti i themelimit, u perpilua ne 2(dy) kopje ne gjuhen shqipe, per t'iu shperndare organeve kopetente dhe nje kopje mbetet ne dokumentacionin baze te shoqerise tregetare "ALB MAIORA" sh.p.k.

Akti i themelimit nenshkruset rregullisht nga ortaku themelues.

### **ORTAKU THEMELUES**

**Znj. Parashevi Taga**

PARASHEVI TAGA

